

Buletini mujor

03/04/2023

Oda Ekonomike e Kosovës,
Nëna Terezë, 10000 Prishtinë
www.oek-kcc.org, info@oek-kcc.org,
038 224 299

PËRMBAJTJA

1. Pasqyrë e Ekonomisë

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës. Është institucion në shërbim të ekonomisë kosovare, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike.

OEK-u është organizatë profesionale, e pavarur, jopolitike dhe jo-fitimprurëse. Është përfaqësuese legjitime e interesave të komunitetit të biznesit në Kosovë. Është burim i besueshëm i informatave për ndërmarrjet kosovare si dhe për ndërlidhjen me partner ndërkombëtar, analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bën ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare. Ka shtrirje në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës.

1. Pasqyrë e Ekonomisë së Kosovës

Bruto Produkti Vendor (BPV) në TM4 2022 shënon rritje reale për 3.55%, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve

Ekonomike është si vijon: Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin:

Industria përpunuese (12.52%), Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (11.53%), Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike, Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (8.71%), Industria e nxjerrëse dhe përpunuese, energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër, furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe rehabilitimi (7.93%), Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, transporti dhe magazinimi, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (6.16%), Informacioni dhe komunikimi (5.94%), Artet, argëtimi dhe çlodhja, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vetë dhe shërbime të tjera (5.41%), Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (3.35%), Aktivitetet e pasurive të paluajtshme (1.76%), Administrata publike, sigurimi social, arsimit dhe shëndetësia (0.53%).


Ndërsa, aktiviteti ekonomik, që shënoi rënie në këtë tremujor ishte: Ndërtimtaria (-11.81%).

Ndërkaq, komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve, që kishin rritje ishin:

Shpenzimet e konsumit final (1.00%) dhe Eksporti i mallrave dhe shërbimeve (9.54%).

Ndërsa, rënie kishte: Importi i mallrave dhe shërbimeve (-4.96%), Formimi i bruto kapitalit (-8.78%) dhe Shpenzimet e Qeverisë (-0.48%).¹

Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak



¹ Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, TM4 2022 |

Statistikat tregtare për muajin Shkurt 2023

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për (-9.2%) në muajin shkurt 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 317.5 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 349.5 milion Euro në vitin 2022. Eksporti mbulon importin me 18.7%.

Eksporti i mallrave në muajin shkurt 2023 kishte vlerën 73.1 milion Euro, ndërsa importi 390.6 milion Euro, që është një rritje prej 12.1% për eksport, si dhe një rënie (-5.8%) për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Sipas të dhënave të grupeve kryesore për eksport: 20.1% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre 16.2% e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar, 14.1% e përbëjnë produktet minerale, 13.1% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, 8.1% e përbëjnë ushqimet e përgatitura pijet dhe duhani, 4.0% e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij, etj.²

(në mijë Euro)

Periudha	Eksportet (FOB)	Importet (CIF)	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2022	920.405	5.639.393	-4.718.989	16,3
01-2022	64.220	338.114	-273.894	19,0
02-2022	65.256	414.770	-349.515	15,7
03-2022	88.600	493.917	-405.317	17,9
04-2022	80.997	462.742	-381.745	17,5
05-2022	76.033	443.892	-367.859	17,1
06-2022	74.642	492.832	-418.190	15,1
07-2022	76.298	502.414	-426.116	15,2
08-2022	84.891	526.829	-441.938	16,1
09-2022	77.059	478.167	-401.109	16,1
10-2022	86.402	488.774	-402.372	17,7
11-2022	73.955	475.419	-401.464	15,6
12-2022	72.054	521.522	-449.469	13,8
01-2023	62.175	353.720	-291.545	17,6
02-2023	73.170	390.688	-317.518	18,7

Tab1. Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 12.8% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, 12.0% e përbëjnë produktet minerale, 11.8% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 9.9% e përbëjnë mjetet e transportit, 9.7% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 7.4% e përbëjnë produkte të industrisë kimike, 6.1% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.

² Agjencia e Statistikave të Kosovës -Statistikat e Tregtisë së Jashtme(Eksporti), Shkurt 2023

Tregtia e jashtme e mallrave me 27 vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 23.5 milion Euro, ose rreth 32.2% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 21.9%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (9.3%), Danimarka (5.8%), Italia (4.3%), etj.³

(në mijë Euro)

Vendet	Shkurt - 2022		Shkurt - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	65.256	100,0	73.170	100,0
27 vendet e BE_së	19.312	29,6	23.533	32,2
Austria	782	1,2	672	0,9
Belgjika	1.262	1,9	1.364	1,9
Danimarka	36	0,1	4.248	5,8
Franca	786	1,2	1.108	1,5
Gjermania	5.738	8,8	6.797	9,3
Greqia	445	0,7	558	0,8
Holanda	1.506	2,3	1.956	2,7
Hungaria	483	0,7	268	0,4
Irlanda	7	0,0	59	0,1
Italia	3.317	5,1	3.128	4,3
Luksemburg	85	0,1	33	0,0
Polonia	269	0,4	963	1,3
Republika Çeke	948	1,5	47	0,1
Slovakia	34	0,1	55	0,1
Slovenia	349	0,5	175	0,2
Spanja	67	0,1	30	0,0
Suedia	466	0,7	272	0,4
Rumani	289	0,4	164	0,2
Bullgaria	1.549	2,4	735	1,0
Kroacia	800	1,2	759	1,0
Të tjera të BE_së	93	0,1	144	0,2

Tab2. Eksportet në muajin shkurt 2023 me vendet e BE-së

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës Tregtia e Jashtme e Mallrave (Eksporti sipas vendeve të BE-së), Shkurt 2023

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 173.1 milion Euro, ose 44.3% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-9.1%). Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (13.0%), Italia (6.6%), Greqia (4.8%), etj.⁴

(në mijë Euro)

Vendet	Shkurt - 2022		Shkurt - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Importet (CIF)			
Gjithsej	414.770	100,0	390.688	100,0
27 vendet e BE_së	190.483	45,9	173.163	44,3
Austria	5.983	1,4	8.164	2,1
Belgjika	1.887	0,5	1.703	0,4
Danimarka	2.082	0,5	2.969	0,8
Franca	6.794	1,6	5.589	1,4
Gjermania	44.827	10,8	50.784	13,0
Greqia	9.850	2,4	18.876	4,8
Holanda	4.776	1,2	3.995	1,0
Hungaria	5.611	1,4	5.236	1,3
Irlanda	376	0,1	238	0,1
Italia	16.390	4,0	25.818	6,6
Luksemburg	62	0,0	176	0,0
Polonia	9.311	2,2	11.074	2,8
Republika Çeke	2.803	0,7	5.560	1,4
Slovakia	1.762	0,4	2.138	0,5
Slovenia	51.329	12,4	7.484	1,9
Spanja	5.776	1,4	3.152	0,8
Suedia	606	0,1	766	0,2
Rumani	4.096	1,0	5.755	1,5
Bullgaria	6.106	1,5	5.445	1,4
Kroacia	7.638	1,8	6.264	1,6
Të tjera të BE_së	2.418	0,6	1.980	0,5

Tab.3: Importet në muajin shkurt 2023 me vendet e BE-së

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës Tregtia e Jashtme e Mallrave (Importi sipas vendeve të BE-së), Shkurt 2023

Tregtia me vendet e CEFTA-së

Në muajin shkurt 2023, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 27.2 milion Euro, ose 37.3% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 23.5%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-së ishin: Maqedonia e Veriut (14.7%), Shqipëria (10.5%), Serbia (6.2%), dhe Mali i Zi (4.6%).

CeFTA	22.080	33,8	27.275	37,3
Shqipëria	5.774	8,8	7.706	10,5
Maqedonia	8.731	13,4	10.721	14,7
Mali i Zi	2.547	3,9	3.393	4,6
Serbia	4.119	6,3	4.505	6,2
Bosnja dhe Hercegovina	909	1,4	947	1,3
Moldavia	:	:	2	0,0

Tab4. Eksportet në muajin shkurt 2023 me vendet e CEFTA-s


Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s në muajin shkurt 2023, arritën në 61.7 milion Euro, ose 15.8% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-9.3%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (5.5%), Shqipëria (4.6%), dhe Maqedonia e Veriut (4.5%)..⁵

CeFTA	68.093	16,4	61.737	15,8
Shqipëria	18.335	4,4	17.813	4,6
Maqedonia	20.507	4,9	17.742	4,5
Mali i Zi	607	0,1	619	0,2
Serbia	24.642	5,9	21.506	5,5
Bosnja dhe Hercegovina	3.913	0,9	3.935	1,0
Moldavia	89	0,0	123	0,0


Tab5. Importet në muajin shkurt 2023 me vendet e CEFTA-s

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës-Tregtia e Jashtme e mallrave (Importii me vendet e CEFTA-s), Shkurt 2023

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 22.3 milion Euro, ose 30.6%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: SHBA (11.3%) dhe Zvicra (8.0%).



Ndërsa, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 155.7 milion Euro, ose 39.9%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14.7%) dhe Kina (10.4%).⁶




⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës –Tregtia e Jashtme e Mallrave (Eksporti dhe Importi me vendet e tjera të botës),Shkurt 2023

Inflacioni mujor dhe vjetor


Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.9% në muajin Janar 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: perime(10.4%); energji elektrike (3.1%), duhan (2.6%), mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (2.2%), pemë(1.9%), shërbime financiare

(1.8%), pajisje shtëpiake (1.8%), shërbime rekreative dhe kulturore (1.6%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (1.6%); qumësht, djathë dhe vezë (1.5%), pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (1.5%), bukë dhe drithëra (1.2%), prodhime ushqimore (0.8%), blerje e automjeteve (0.8%), shërbime ambulatorie (0.6%), mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (0.2%), kafe, çaj dhe kakao (0.1%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.9 për qind në IHÇK.

NDRYSHIMET MUJORE TE CMIMEVE PER 2022
-Janar 2023



NDRYSHIMET VJETORE TE CMIMEVE PER 2022 -Janar 2023



Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 12.1% në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: vajra dhe yndyra (26.0%); bukë dhe drithëra (21.2%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (20.5%); mish (18.9%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (18.9%); prodhime ushqimore (16.5%); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (16.3%); energji elektrike (15.4%); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (13.3%); perime (10.8%); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (10.7%); mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve personale të transportit (10.6%); peshk (10.4%); qumësht, djathë dhe vezë (10.4%); pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (9.9%); mbrojtje sociale (9.5%); pije alkoolike (9.4%); kafe, çaj dhe kakao (9.0%); pemë (8.8%); mobile dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (8.8%); gaz (7.7%); gjëra dhe pajisje të tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (7.6%); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (7.5%); gjëra personale (7.4%); tekstile shtëpiake (7.3%); pajisje shtëpiake (6.4%); blerje e automjeteve (6.2%); veshje (5.7%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 12.1 për qind në IHÇK.⁷

⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin janar 2023

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM4 - 2022


Në TM4 2022 krahasuar me tremujorin paraprak (TM3 2022) kemi rënje për 3.15% të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2021) kemi rritje për 9.10 % të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 645 (24.5%), Ndërtimtari me 322 (12.2%), Prodhim me 262 (9.9%), Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 254 (9.6%), Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 232 (8.8%) etj.


Në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsej 2,543 ndërmarrje të regjistruara në këtë tremujor (96.5 %), me 5 deri 9 të punësuar janë 59 sosh (2.2%), 10 deri në 19 të punësuar 22 (0.8%), 20 deri 249 të punësuar me 12 (0.5%) ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar nuk kemi ndërmarrje gjatë këtij tremujori.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave ashtu si në çdo tremujorë mbizotëron komuna e Prishtinës me 809 ndërmarrje të regjistruara (30.7%), Ferizaj me 233 (8.8%), Prizreni me 178 (6.8%), Peja 142 (5.4%), Gjilani me 130 (4.9%), dhe Gjakova me 113 (4.3%), ndërsa komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor.⁸

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas tremujoreve



Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas viteve



⁸ ASK- Numri i ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM4 - 2022

Norma efektive të interesit në bankat komerciale (për muajin Dhjetor 2022)⁹	
Norma në kredi[^]	6.3%
<i>për ekonomitë familjare</i>	6.1%
prej të cilave konsumuese	6.3%
prej të cilave hipotekare	5.4%
<i>për ndërmarrje</i>	6.7%
prej të cilave bujqësore	-----%
prej të cilave industriale	6.5%
prej të cilave shërbyese	6.7%
Norma në depozita ^{^^}	2.0%
<i>të ekonomive familjare</i>	1.8%
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.1%
prej të cilave të afatizuara	1.8%
<i>të ndërmarrjeve</i>	2.4%
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.1%
prej të cilave të afatizuara	1.8%
Dallimi i normës Kredi – Depozita	4.5 pp
[^] mesatare e peshuar e normave të interesit për kreditë e reja	
^{^^} mesatare e peshuar e normave të interesit në depozitat e reja	

⁹ Banka Qendrore e Kosovës – Informatat mujore të sistemit financiar, shkurt 2023

Njësitë rajonale të Odës Ekonomike të Kosovës nëpër Kosovë

Njësia Rajonale Pejë:

Personi kontaktues: z. Samir Lleshi
Rr. Çarshia e gjatë -
Qendra tregtare Burma kati.2, 30000 Pejë
Tel: 045/ 560 - 999
email: samir.lleshi@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Mitrovicë:

Personi kontaktues: z. Besart Kostanica
Rr. Mbretëresha Teutë, p.n. 40010 Mitrovicë
Tel: 045/ 619 - 519
email: Besart.kostanica@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Gjilan:

Personi kontaktues: z. Ibrahim Tahiri
Rr. Abdullah Tahiri, p.n. 60000 Gjilan
Tel: 045/ 699 692
email: ibrahim.tahiri@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Ferizaj:

Personi kontaktues: z. Lulzim Azemi
Rr. Dëshmorët e Kombit, nr. 144, 70000 Ferizaj
Tel: 045/ 580 - 666
email: lulzim.azemi@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Prizren:

Personi kontaktues: z. Armend Hyseni
Rr. Remzi Ademi, nr. 27, 20000 Prizren
Tel: 049/ 709 - 657
email: armend-hyseni@hotmail.com

Referencat

Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës (ARBK) – Statistikat e tregtisë së jashtme shkurt 2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Repertori statistikor mbi ndermarrjet ekonomike në Kosovë TM4 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit dhjetor 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve dhe prodhimit TM4 2022

Banka Qendrore e Kosovës – Sistemi financiar shkurt 2023

Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Komunikim Strategjik

Buletini Ekonomik Mujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë për tremujorin raportues. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë informativ për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.